

## Vendim nr. 17 datë 22.01.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare  
Marsida Xhaferllari, Anëtare  
Marjana Semini, Anëtare

në datën 22.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (S) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE: SOSE BUÇPAPAJ**

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. (1409) 342, datë 18.12.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës; nr. 23, datë 30.01.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2024-1269, datë 09.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; vendimit të ndërmjetëm nr. regj. themeltar (76007-00614-55-2018) 342, datë 18.12.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor gjatë gjykimit në Gjykatën e Shkallës së Parë Kukës në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe në Gjykatën e Lartë.

Cenimi i së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, së drejtës për t'u dëgjuar, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, së drejtës së mbrojtjes e të ankimit, aksesit në gjykatë, kompetencës ligjore pas transferimit të prokurorit, parimit të barazisë përpara ligjit, parimit të mosdiskriminimit, standardit të vlerësimit juridik, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim, pozitës dhe figurës të vendimeve me akte dhe sjellje që diskreditojnë figurën e gjyqtarit dhe të prokurorit.

**Kthimi i çështjes për rihetim në një prokurori jashtë juridiksionit të prokurorisë së Kukësit.**

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 18, 42, 43, 118, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 137, 140, pika 1, shkronja “a”, 142, pika 1, 145, pika 1, shkronja “a”, 148, pika 1 dhe 148/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Kërkesja Sose Buçpapaj ka ushtruar detyrën e inspektores së ushqimit në Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (*AKU*), Kukës. Me vendimin nr. 1209/3, datë 19.11.2014, komisioni disiplinor ka vendosur marrjen e masës disiplinore të largimit nga Shërbimi Civil, ndërsa me urdhrin nr. 1209/4 prot., datë 24.11.2014 të drejtorit të AKU-së është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës, duke filluar nga data 24.11.2014.

2. Kërkesja ka paraqitur kallëzim penal ndaj ish-kolegëve të saj, duke pretenduar se kishin falsifikuar dokumentet që kishin shërbyer për largimin e saj nga puna. Me fillimin e procesit penal ndaj ish-kolegëve, kërkesja ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit që po gjykonte çështjen. Në vijim, kërkesja ka pretenduar se i gjithë fashikulli i kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit është zhdukur dhe për këtë qëllim ka bërë kallëzim penal ndaj atij dhe kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

#### *II. Procesi i parë (kallëzimi penal ndaj ish-kolegëve)*

3. Në datën 24.12.2014 kërkesja ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ndaj ish-kolegëve të saj, duke i akuzuar për kryerjen e

veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi 2, i Kodit Penal (KP). Për shkak të moskompetencës së kësaj prokurorie çështja i ka kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe për gjykimin e çështjes është caktuar gjyqtari A.H. Në datën 03.10.2016 kërkesja ka ngritur padi civile në procesin penal, për të cilën është vendosur veçimi nga procesi penal.

4. Në datën 07.10.2016 kërkesja ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit A.H., i cili ishte shortuar për shqyrtimin e çështjes penale. Ajo ka pretenduar se dy prej të pandehurve kanë lidhje krushqie dhe familjare me të. Në datën 22.10.2016 kërkesja ka paraqitur përsëri kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit A.H., e cila pas shortimit është marrë në shqyrtim nga gjyqtar tjetër, D.S., i cili, me vendimin e datës 01.11.2016, ka vendosur mospranimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit.

5. Në vijim, për shkak të transferimit të gjyqtarit A.H. në një gjykatë tjetër, për gjykimin e çështjes penale është caktuar, nëpërmjet shortit, gjyqtari E.Ç. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë (gjyqtari E.Ç.), me vendimin nr. 43, datë 04.04.2017, ka vendosur deklarin e pafajshëm të ish-kolegëve A.Z., S.R., F.I. dhe H.D., pasi nuk është provuar ekzistenca e të gjitha elementeve përbërëse të figurës së veprës penale. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 706, datë 12.07.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 43, datë 04.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

6. Kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke pretenduar shfuqizimin e vendimeve të sipërcituara për shkak të cenimit të së drejtës për t’u dëgjuar, për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, të aksesit të lidhur me të drejtën për t’u mbrojtur, ankimit efektiv, marrjes së provës në mënyrë të paligjshme, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, standardit të arsytimit të vendimit dhe parimit të sigurisë juridike. Me vendimin nr. 67, datë 05.04.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak të moslegjitimitit *ratione personae* të kërkueses.

## *II. Procesi i dytë, objekt shqyrtimi i kërkesës*

7. Kërkesja, duke pretenduar se kërkesa e paraqitur për përjashtimin e gjyqtarit gjatë gjykimin penal ndaj ish-kolegëve ishte zhdukur, ka bërë kallëzim penal ndaj gjyqtarit A.H. dhe kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Me shkresë të Prokurorisë së Përgjithshme

hetimet e çështjes i janë deleguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, e cila ka regjistruar procedimin penal nr. 227, datë 14.06.2018.

8. Për këtë kallëzim, prokuroria, bazuar në nenet 328, pika 1, shkronja “a” dhe 329/a të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), ka arritur në konkluzionin se “del qartë se fakti nuk ekziston”, për rrjedhojë ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë dhe çështja duhet të pushohet. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. (1409) 342, datë 18.12.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe pushimin e çështjes penale. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim kërkuësja dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 23, datë 30.01.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. (1409) 342, datë 18.12.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuësja Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1269, datë 09.07.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit.

9. Kërkuësja, në datën 08.11.2024, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), nëpërmjet shërbimit postar me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili është regjistruar në datën 11.11.2024. Kërkuësja në datat 10.12.2024 dhe 27.12.2024 ka vijuar me paraqitjen e materialeve dhe provave për përgjegjësinë penale të prokurorëve dhe gjyqtarëve që kanë hetuar dhe gjykuar kërkesat e paraqitura nga ajo, si person i dëmtuar dhe viktimë e veprës penale.

## II

### Pretendimet e kërkuësjes

10. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se:

10.1. *Është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1.1. *Së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën e ankimit efektiv*, pasi apeli dhe rekursi nuk kanë rezultuar të jenë efektivë. Mosshqyrtimi dhe mosvlerësimi i akteve, si, apeli i datës 25.01.2019, memoja e datës 03.05.2024, kërkesat paraprake të paraqitura në datat 12.11.2018, 16.11.2018 dhe 03.05.2024 në të tria shkallët e gjyqësorit i kanë cenuar asaj të drejtën e aksesit. Këto të drejta janë shkelur nga gjyqtarët dhe prokurorët gjatë procesit gjyqësor të kërkuësjes, në cilësinë e viktimës së veprës penale dhe kallëzueses.

10.1.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim*, të garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

10.1.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi për shqyrtimin e çështjes është shortuar gjyqtari A.H., njëkohësisht edhe kryetar i kësaj gjykate, për të cilin është kërkuar përjashtimi. Kërkesa e parë është paraqitur në datën 07.10.2016, por ajo nuk është protokolluar dhe nuk ekziston në dosje. Kërkesa e dytë është paraqitur në datën 22.10.2016, por është vendosur mospranimi i saj. Për pasojë, gjyqtari A.H. ka vijuar me veçimin e padisë civile nga procesi penal, ndonëse proceset kishin lidhje së bashku dhe kërkesja nuk është legjitimuar si palë në gjykimin penal. Kërkesja ka paraqitur kërkesë edhe për pezullimin e shqyrtimit të çështjes penale deri në përfundimin e çështjes civile, por nuk është vlerësuar. Gjykata duhet të administrojë si provë certifikatat e gjendjes civile për të provuar lidhjet familjare, miqësore, shoqërore dhe konfliktin e interesit të hapur të gjyqtarit A.H. dhe dy të akuzuarve. Gjyqtari i çështjes ishte edhe kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Procesi dhe kërkesa për përjashtimin e tij duhej të shqyrtohej nga një gjyqtar i gjykatës së apelit.

10.1.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë ka abuzuar dhe është mjaftuar me një arsyetim formal, duke u bazuar në vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk ka analizuar memon dhe parashtrimet urgjente nr. 2244, datë 03.05.2024. Gjykata e Lartë ka abuzuar dhe ka mashtruar, duke mos iu referuar fakteve dhe provave. Konkretisht, kërkesa e prokurorit për pushimin e çështjes nuk mban datën, por vetëm vitin 2018, pasi në datën 13.11.2018 prokurori i çështjes nga prokuroria e Kukësit është transferuar në atë të Kavajës. Në fakt, hetimet paraprake janë mbyllur në datën 08.11.2018, njoftimi është i datës 09.11.2018, ndërsa njoftimi i pushimit të çështjes është bërë në datën 20.11.2018. Të gjitha këto janë prova të pakontestueshme për pavlefshmërinë e kërkesës për pushimin e çështjes. Gjykata duhet të japë përgjigje se përse Gjykata e Lartë ka abuzuar e mashtruar dhe përse nuk janë vlerësuar provat, sikur është shkresa e Prokurorisë së Përgjithshme, sipas së cilës prokurori është transferuar në datën 13.11.2018. Prokuroria ka mashtruar kur pohon se kërkesa për pushimin e çështjes penale mban datën 08.11.2018, pasi nëse do të ishte e vërtetë duhej t'i njoftohej po në këtë datë edhe kërkueses. Gjykata duhet të pranojë kërkesën paraprake për pavlefshmërinë e vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes, për shkak

të manipulimit të datës dhe ushtrimit të detyrës në kundërshtim me ligjin. Gjykata e Lartë ka abuzuar edhe me datat e paraqitjes së kërkesave për përjashtimin e gjyqtarit, duke u shprehur se mbajnë datat 05.10.2016, 07.10.2016 dhe 22.10.2016, në një kohë kur gjykimi ka filluar në datën 06.10.2016.

10.2. *Marrja dhe administrimi i provave janë në kundërshtim me ligjin*, pasi hetimi i prokurorit ndaj gjyqtarit A.H. ka qenë i kompromentuar. Më konkretisht, me shkresat e kancelarit të Gjykatës së Apelit Shkodër, që ndodhen të administruara së bashku me kallëzimin penal, rezulton se kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit nuk ndodhet në dosjen penale në Gjykatën e Apelit Shkodër, në një kohë kur nga shërbimi postar i qytetit të Tropojës shkresa i është dorëzuar personalisht gjyqtarit A.H., të cilën e ka fshehur qëllimisht. Prokurori nuk ka thirrur gjyqtarin e akuzuar për ta marrë në pyetje dhe oficeri i policisë nuk i ka bërë asnjë pyetje kancelarit të gjykatës në lidhje me faktet e parashtruara në kallëzimin penal. Janë paraqitur prova të pakontestueshme për zhdukjen fizike të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit, ndërsa prokurori shprehet se nuk është përpara kryerjes së veprës penale. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit është bërë pjesë e dosjes civile nr. 58 dhe për këtë Gjykata duhet të gjejë kush ka akses në aktet dhe provat e fashikullit të dosjes penale.

10.3. Vendimi i ndërmjetëm nr. 69, datë 21.10.2016 i gjyqtarit A.H., për veçimin e padisë civile të paraqitur në procesin penal duhet të shfuqizohet.

10.4. Gjykata duhet të marrë certifikatat e gjendjes civile, të cilat provojnë lidhjet familjare, miqësore, shoqërore mes gjyqtarit dhe të akuzuarve.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. *Për legjitimitimin e kërkueses*

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen

me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individit duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial.

13. Kolegji vëren se kërkesja ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal në përfundim të të cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës së saj ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes penale për zhdukjen e fashikullit të përjashtimit të gjyqtarit. Për rrjedhojë, kërkesja, në aspektin procedural, ka qenë palë/kallëzuese në procesin e kundërshtuar.

14. Ndërsa për sa i përket aspektit substancial të këtij kriteri, Gjykata ka theksuar se individit, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkesja duhet të provojë edhe se është bartëse e asaj të drejte/lirie kushtetuese që pretendohet se është cenuar nga vendimet gjyqësore objekt kërkesë.

15. Nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllim të shqyrtimit paraprak të çështjes, rezulton se procesi penal ka nisur pas kallëzimit të kërkeses, e cila ka pretenduar zhdukjen e fashikullit të kërkesës së paraqitur për përjashtimin e gjyqtarit që gjykonte çështjen penale ndaj ish-kolegëve të saj. Prokuroria ka arritur në përfundimin se fakti i pretenduar nga kërkesja, se gjyqtari në bashkëpunim me kancelarin e gjykatës kanë hequr nga dosja kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, nuk ekziston dhe ka kërkuar pushimin e çështjes. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. (1409) 342, datë 18.12.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe pushimin e çështjes penale të regjistruar për veprën penale “Zhdukja ose humbja e fashikullit”, të parashikuar nga neni 313/a i KP-së, për shkak se ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë, pasi del qartë që fakti nuk ekziston. Pas ankimit të kërkeses, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 23, datë 30.01.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga kërkesja.

16. Duke mbajtur parasysh faktet dhe natyrën e çështjes, Kolegji do të analizojë se cila e drejtë kushtetuese substanciale e kërkeses mund të vihet në diskutim se është cenuar në rastin konkret, në drejtim të pasojave që i kanë ardhur drejtpërdrejt asaj.

17. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkesja pas largimit nga detyra si inspektore pranë AKU-së, Kukës, krahas procesit gjyqësor për mosmarrëveshjen e lindur për këtë shkak, ka kërkuar të nisë disa procedime penale ndaj: a) ish-kolegëve, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi 2, i KP-së; b) gjyqtarit dhe kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, duke i akuzuar për veprën penale “Zhdukja ose humbja e fashikullit”, konkretisht të kërkesës së paraqitur nga ajo për përjashtimin e gjyqtarit që kishte filluar gjykimin e çështjes penale ndaj ish-kolegëve.

18. Kolegji, duke pasur parasysh interesin dhe qëllimin e kërkeses, që është kthimi në detyrën e saj, vlerëson se pavarësisht se objekt i ankimit kushtetues individual janë vendimet gjyqësore të dhëna gjatë procesit gjyqësor penal për zhdukjen e fashikullit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit, në thelb, e drejta substanciale që kërkesja kërkon të mbrojtë është e drejta për punë.

19. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkesja ka pretenduar se është person i dëmtuar si pasojë e kryerjes së veprës penale “Zhdukja ose humbja e fashikullit”, të parashikuar në nenin 313 të KP-së. Kjo veprë penale nuk bën pjesë në ato vepra për të cilat KPP-ja parashikon se ndiqen mbi kallëzimin e personit të dëmtuar, por në rastin konkret ndjekja penale ushtrohet kryesisht nga Prokuroria, e cila sipas nenit 148, pika 1, të Kushtetutës ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, që do të thotë se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit dhe është pikërisht prokuroria, organi i specializuar që ushtron ndjekjen penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë. Për këtë arsye, Kolegji vëren se, në raste të tilla, gjykimi kushtetues nuk mund të vihet në lëvizje nga individi që pretendon se ka pësuar dëm nga vepra penale, bazuar vetëm në pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor, pa provuar cenimin e ndonjë të drejte substanciale të lidhur drejtpërdrejt me procesin penal. Në rastin konkret, efekti ligjor i vendimeve të kundërshtuara nga kërkesja është lënia në fuqi e vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes penale për shkak se fakti i pretenduar për zhdukjen e fashikullit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit nuk ekziston. Këto vendime nuk kanë sjellë dhe as mund të sillnin ndonjë pasojë në të drejtën për punë të kërkeses, të cilën ka pasur mundësinë dhe mjetet juridike ta mbrojtë përmes procesit administrativ.

20. Për sa më lart, Kolegji vlerëson të theksojë se interesi substancial i kërkeses lidhur me të drejtën për punë, rivendosja në vend e së cilës, në rastin konkret, nuk varet nga mënyra e përfundimit të procesit penal objekt kundërshtimi. Edhe në rastin e një vendimi në favor, mjete i përdorur nga kërkesja nuk provohet se do të ofronte një perspektivë suksesi në drejtim të mbrojtjes së të drejtës substanciale, për sa kohë nuk është i tillë që mund të rivendosë të



drejtën e pretenduar të cenuar, pra të drejtën për punë. Për më tepër, Kolegji konstaton se gjyqtari për të cilin është kërkuar përjashtimi ka zhvilluar vetëm seancat e para gjyqësore, pasi është transferuar në një gjykatë tjetër dhe procesi gjyqësor penal ka vijuar e është përfunduar nga një gjyqtar tjetër. Për të gjitha këto arsye, Kolegji vlerëson se kërkesja nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

21. Në përfundim, Kolegji çmon se në kushtet kur kriteri paraprak për legjitimimin *ratione personae* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre. Për rrjedhojë, ankimi kushtetues individual i kërkueses nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.